



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
OSNOVNI SUD DJAKOVICA – BASIC COURT OF GJAKOVË

AD/GJTHGJA.nr. 02/24

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – kryetari i gjykatës Nikollë Komani, duke vendosur përkitazi me ankesën disiplinore të parashtruar nga ankuesi B. S. avokat në Ferizaj, ndaj gjyqtarit D. B., pas shikimit të shkresave të lëndës dhe vlerësimit të ankesës, me datë 10 tetor 2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet ankesa disiplinore e parashtruar nga avokati B. S., ndaj gjyqtarit D. B., si e pabazuar.

A r s y e t i m

Me datën 03 tetor 2024 Këshilli Gjyqësor i Kosovës, konform nenit 9 par.1 pika 1.1 lidhur me par.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ka përcjellë te autoriteti kompetent ankesën disiplinore të parashtruar nga B. S. avokat në Ferizaj, ndaj gjyqtarit D. B..

Pas pranimit të kësaj ankese dhe pas analizimit të përmbajtjes së saj, e njëjta është regjistruar në librin e ankesave disiplinore me numër AD/GJTHGJA.nr. 02/24 me datën 03 tetor 2024 dhe janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore që janë në kompetencë të kryetarit të Gjykatës, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë.

Me shkresën AD/GJTHGJA.nr.02/2024 të datës 03 tetor 2024, përmes email-it zyrtar është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës, për veprimet e ndërmarra lidhur me ankesën e parashtruar nga ana e ankuesit.

Ankuesi, B. S. avokat në Ferizaj, në ankesën e tij të paraqitur kundër gjyqtarit D. B. ka theksuar se në lëndën C. nr. 212/19 janë mbajtur tre seanca gjyqësore, janë bërë tre ekspertiza dhe atë dy mjekësore dhe një ekspertizë financiare. Si përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse ka marrë pjesë në çdo seancë në mënyrë të rregullt dhe në seancën e fundit ku vetë nuk ka marrë pjesë është aprovuar propozimi që të kryhet edhe një ekspertizë financiare ku kemi deponuar mjetet për ekspertizë. Ka shtuar se pas pranimit të ekspertizës gjykata me datë 10.07.2024 përmes postes e dërgon ekspertizën, ku në zarf ka qenë vetëm ekspertiza, kurse fare nuk ka pasur ftesë në pliko, çka nënkupton se për seancën e datës 06.08.2024 nuk ka qenë i ftuar pasi që nuk ka pasur ftesë dhe gjykata pas seancës e ka konsideruar padinë e tërhequr ku ka nxjerr aktvendim lidhur me këtë çështje. Ka bërë kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme duke e arsyetuar se nuk e ka pranuar ftesën nga ana e gjykatës dhe kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme është refuzuar me aktvendimin C. nr. 212/19 të datës 11.09.2024 dhe për këtë e kam njoftuar kryetarin e Gjykatës Themelore në Gjakovë. Ndër të tjera ka theksuar se rasti im duhet të trajtohet nga komisioni disiplinor i KGJK-së, pasi konsideron se gjykatësi në fjalë dhe administrata qëllimshëm nuk e kanë vendosur ftesën në plikon (zarfin) që e kam pranuar dhe me gabimin e tij ose të administratës qoftë me qëllim apo pa qëllim nuk e ka vendosur ftesën në pliko dhe më këtë veprim ma ka pamundësuar që unë të jem në seancë. Për shkak se nuk ma ka dërguar ftesën me rregull, pasi që në plikon e ardhur që unë e kam pranuar ka qenë vetëm ekspertiza e ekspertit financiar por se nuk ka pasur ftesë në pliko, unë nuk kam qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e datës 06.08.2024 sepse nuk kam pasur ftesë nga gjykata. Ka shtuar se unë mund të betohem në çdo gjë, të mbaj përgjegjësi penale dhe çdo lloj përgjegjësie por jam i obliguar ta paraqes të vërtetën dhe ajo e vërtetë është se ftesë nuk ka pasur në plikon e pranuar me datë 10.07.2024. Ka theksuar se ju lus që të trajtohet kjo ankesë të ndërmerren veprimet e nevojshme dhe të na bëni te mundur që çështja të kthehet në gjendjen e mëparshme sepse me vendimin e gjykatës palës është duke ju bërë një dëm i madh financiar, moral dhe i njëjti të drejtën e tij subjektive nuk po mund ta realizon për shkak të gabimeve-lëshimeve të gjykatës-gjyqtarit në fjalë. Po ashtu një dëm i madh dhe një poshtërim është duke ma bërë edhe mua si avokat pasi sipas palës paditëse që unë e përfaqësoj unë kam neglizhu se nuk kam qenë në seancë (sipas pretendimit të gjyqtarit të çështjes) edhe pse unë nuk kam aspak faj sepse ftesë nuk kam pasur nga gjykata.

Gjyqtari D. B., në deklaratën e tij të dhënë me shkrim lidhur me pretendimet e ankuesit ndër të tjera ka theksuar se gjykata e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor për datën 06.08.2024 në të cilën nuk ka prezantuar paditësi, përkatësisht i autorizuari i tij, pavarësisht faktit se i njëjti ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për vendin dhe kohën e mbajtjes se seancës, siç u provua nga fletë kthesa e dorëzuar përmes shërbimit postar të Postës së Kosovës e pranuar me datë 08.07.2024, po ashtu nuk ka prezantuar askush nga e paditura, e cila për kohën dhe vendin e mbajtjes së seancës ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullte, pasi që ftesën për seancë e ka pranuar me datë 10.07.2024. Meqenëse paditësi, përkatësisht i autorizuari i tij, për seancën e lartcekur ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, ndërsa mungesën nuk e ka paralajmëruar dhe arsyetuar, gjykata ka vepruar në kuptim të nenin 423 paragrafi 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, në të cilin është paraparë se *“Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën kryesore, edhe pse është thirrur rregullisht, konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit”*, duke e konsideruar të tërhequr padinë e paditësit. I autorizuari i paditësit me datë 19.08.2024 në këtë gjykatë ka paraqitur kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme, në të cilën ka theksuar se i autorizuari i paditësit nuk ka pranuar ftesë për seancën e datës 10.07.2024, pasi që përmes postes kam pranuar vetëm ekspertizën financiare, mirëpo jo edhe

ftesën për seancë dhe pasi që nuk ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e datës 08.08.2024 ka propozuar që gjykata ta aprovoj kërkesën për kthim në gjendje të mëparshme. Pas shikimit dhe vlerësimit të kërkesës për kthim në gjendje të mëparshme, e duke marrë parasysh faktin se fletë dërgesa për dorëzim personal, përkatësisht tek hapësira “titulli i shkresës që dërgohet” është shënuar “thirrje për seancë dt. 06.06.2024, 09:15”, e që në rast që se i autorizuari i paditësit avokati B. S., me rastin e pranimit të kësaj fletë dërgese për dorëzim personal me përshkrim si me lartë nuk ka pranuar dokumentet e evidentuar si në përshkrim në këtë rast ftesën për seancë, i njëjti do duhej të evidentonte vërejtje në lidhje me këtë çështje. Andaj, konsideroj se ankesa e parashtruar në drejtim për shkelje të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve është e pabazuar, ndërkaq deklaratimet e paraqitësit të kërkesës janë të pabazuara dhe asnjë nga to nuk qëndrojnë pasi që veprimet e ndërmarra në këtë çështje deri me tani janë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, ndërsa ndaj vendimit C.nr. 212/19 të datës 06.08.2024, është parashtruar ankesë, e cila për trajtim të mëtutjeshëm do të procedohet në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.

Kryetari i Gjykatës, pas vlerësimit dhe analizimit të ankesës së ankuesit, deklaratës së gjyqtarit, si dhe shkresave të lëndës C.nr.212/19, gjeti se **ankesa është e pabazuar**.

Kryetari i Gjykatës, ka vlerësuar dhe analizuar pretendimet e ankuesit se për seancën e shqyrtimit kryesor për datën 06.08.2024, nuk ka qenë i ftuar, pasi që në zarf nuk ka pasur ftesë për seancë por ka qenë vetëm ekspertiza dhe ka konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës C.nr. 212/19, gjegjësisht nga fletë dërgesa që gjykata ja ka dorëzuar përfaqësuesit të autorizuar të paditësit këtu ankuesit është e konstatuar e kundërta e asaj që pretendon ankuesi, pasi që bazuar në këtë fletë dërgese tek hapësira “titulli i shkresës që dërgohet”, është e shënuar “thirrje për seancë dt. 06.06.2024, 09:15”, e cila thirrje është pranuar dhe nënshkruar me datë 08.07.2024 nga ankuesi pa asnjë vërejtje. Andaj, bazuar në këto argumente, kryetari i Gjykatës ka konstatuar se në veprimet e gjyqtarit nuk ka asnjë shkelje e cila do të konsiderohej si shkelje disiplinore pasi që gjyqtari ka përpiluar procesverbal me datë 06.08.2024, ku ka konstatuar se kush nga palët ka qenë i pranishëm, pastaj me rastin e marrjes së aktvendimit C.nr.212/19 të datës 06.08.2024 me të cilin e ka konsideruar padinë e tërhequr ka vepruar bazuar në nenin 423 par. 3 të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe si të tilla vendimet e marra nga gjyqtari janë konform dispozitave ligjore të parapara me Ligjin për Procedurën Kontestimore dhe nuk përbëjnë shkelje disiplinore ashtu siç pretendon ankuesi.

Po ashtu, është vlerësuar dhe analizuar kërkesa e ankuesit që të trajtohet ankesa dhe të ndërmerren veprimet e nevojshme që çështja të kthehet në gjendjen e mëparshme dhe vlerësohet se një kërkesë e tillë është e pabazuar, pasi që kryetari i Gjykatës nuk ka kompetencë ligjore për të marrë vendim për kthimin në gjendje të mëparshme por është Gjykata e Apelit ashtu siç ka vepruar edhe ankuesi i cili kundër vendimit C.nr.212/19 të datës 11 shtator 2024 me të cilin vendim është refuzuar kërkesa e paditësit për kthim në gjendje të mëparshme ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila do të bie vendim meritor lidhur me pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë.

Andaj, mbi këto baza dhe argumente vërtetohet se në veprimet e gjyqtarit nuk janë konstatuar shkelje të ligjit, të cilat do të konsideroheshin shkelje disiplinore, për këtë arsye kryetari i Gjykatës gjeti se pretendimet ankimore janë të pabazuara, pasi nga të lartcekurat nuk rezulton se veprimet e ndërmarra nga gjyqtari D. B., përbëjnë bazë për iniciimin e procedurës disiplinore në Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Nga arsyet e theksuara më lartë, si dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 9 par. 6 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenit 7 par. 3 pika 3.2 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
AD/GJTHGJA.nr. 02/24, datë 10 tetor 2024

Kryetari i Gjykatës

Nikollë Komani

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Gjyqësor të Kosovës
2. Parashtruesit të ankesës
3. Gjyqtarit